REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 871/20
Datë/Datum. 05.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Lulzim Bajrami **Ekspert Shqyrtues**	**Data e autorizimit të ekspertit** **03.11.2020**	**Data e dorëzimit të raportit** **05.11.2020**

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën 20.10.2020, **operatori ekonomik "SOLUTION D SH.P.K"** ka parashtruar ankesë me **nr: 871/20**, kundër njotimit mbi vendimin e AK ku është rekomanduar për kontratë operatorit ekonomik **"N.SH.T. MADE-KOS "** lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Furnizim me Sterilizator Plazma me Material percjelles hargjues**" me nr. të prokurimit **220-70001-0731-20-5789-1-2-1**. iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK). **Spitali i Përgjithshëm ne Gjilan.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës është **65 000,00 €.**

- Data e njoftimit për kontratë **25.09.2020**
- Data e hapjes së ofertës **16.10.2020**
- Data e (njoftimi për dhanie te kontrates) - njoftimit mbi vendimin e AK **22.10.2020**
- Data e njoftimit të ofertuesve: **22.10.2020**
- Data e njoftimit për dhënje te kontratës: **29.10.2020**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

Operatori ekonomik **"SOLUTION D SH.P.K"** ne ankesën e parashtruar ne pretendimet ankimore ka si ne vijim:

<u>OPERATORI ANKUES PRETENDON SE:</u> AK nuk ka lejuar qasje ne dokumentet tenderuese te operatorit ekonomik te shpallur fitues dhe operatoreve te tjer ofertues:

Të nderuar me dt.22.10.2020 përmes plateformes elektronike te e-prokurimit jemi njoftuar me vendimin e AK. Me leter standarde per tenderuesin e pasuksseshëm ndërsa ka rekomanduar për kontratë OE **"N.SH.T MADE-KOS"**

Fillimisht ju sqarojm se ne dt.22.10.2020 kemi bër kërkesë për qasje në dokumentacione.

Ndërsa me datë 23.10.2020 kemi pranuar një e-mail nga AK ku ka cekur se ..*Duke u bazuar ne nenin11 informatat sekrete afariste ku te gjitha dokuemntet e tenderit te cilat janë dorëzuar nga OE konform nenit 68,69 dhe 70 trajtohen si sekrete afariste.*

*Dokumenti i tenderit i derguar nga OE konform nenit 68,69,70.Janë dokumente private dhe publikimi i tyre pa te drejten e OE e papergjegjeshme dhe mundet te ndikoj ne dëmtim te biznesit dhe dem material..*pra nga emaili i përmendur me larte OE i rekomanduar për kontratë e ka deklaruar te gjitha dokumentacionin e tij sekret afarist, andaj ne dyshojm se kz OE është i papergjegjshëm dhe nuk i ploteson te gjitha kerkesat e FDT dhe te njoftimit per kontrate. Pra AK e ka cekur se i gjitha dokumentacioni i OE te rekomanduar per kontrate eshte sekret afarist dhe na ka lejuar qasje te shikojm vetem raportin e vleresimit.

Andaj pasi qe nuk na eshte lejuar qasja ne dokuemtet e OE te rekomanduar per kontrate sipas nenit 10.3 te LPP ne dyshojm se ky OE është i pa pergjegjshem si ne vijim:

Ne dyshojm se OE i rekomanduar për kontrat është i papergjegjshëm sepse nuk i ka plotesuar te gjitha kerkesat e FDT dhe njoftimit per kontrate perkatesisht kerkesat tek neni 8.1&8.2 tek Kapaciteti ekonomik dhe financiar ku kerkesa ka qenë ..*Vertetim nga banka se ka qarkullim bankar se paku tri vitet e fundit ndersa si deshmi eshte kerkuar OE duhet te deshmoj me vertetim nga banka komerciale qe ka qarkullim 120,000.00 euro per tri vitet e fundit. Pra ne dyshojm se OE i rekomanduar nuk e ploteson kerkesen e lartecekur është i papergjegjshëm.*

Gjithashtu ne dyshojm se OE i ekomanduar per kontratë është i pa pergjegjshem edhe për faktin se nuk i ka plotesuar te gjitha kerkesat e FDT dhe njoftimit per kontrate perkateshisht kerkesat tek kapaciteti teknik dhe profesional neni 91.&9.2 ku kerkesae ka qen *1.Listen e kontratave te realizuara per tri vitet e fundit 2.Se paku tri kontrata dhe tri rreferenca per lami te ngjajshem 3.Autorizim nga prodhuesi per shitje dhe servisim 4.çertifikata ISO 13485 per prodhuesin dhe CE Certifikata per prodhuesin 6.Lista e pjeseve rezerv 7.Licenca nga AKPPM 8.Katalogu i nenvizuar ndersa si deshmi dokumentare eshte kerkuar 1.OE duhet te deshmoj me lsitën e kontratave te realizuara per tri vitet e fundit 2.OE duhet te deshmoj tri kontrata dhe tri referenca ne lami te ngjajshme 3.OE duhet te deshmon me autorizim nga prodhuesi per dhitje dhe servisim 4. OE duhet te deshmoj me certifikata iso 9001 per operatorin ekonomik dhe te kete validitet 5.OE duhet te deshmoj me certifikata iso 13485 per prodhuesin dhe CE certifikatat per prodhuesin 6.OE duhet te deshmoj me lista e pjeseve rezerv 7.OE duhet te deshmoj me licence nga AKPPM me validitet 8.OE duhet te deshmoj me katalogun e nenvizuar.*

Pra duke u bazuar ne faktin se nuk është lejuar qasja ne dokuemntet pasi qe sipas AK OE i rekomanduar per kontrate e ka deklaruar sekret afarist te gjithe dokumentacioni e tij, ne dyshojm se OE i rekomanduar per kontrate nuk i ploteson kerkesat 1 dhe 2 te larte cekur ne lidhje me kontratat pasi qe kontratat e realizuara

eshte absurde te deklarohen si sekret afarist pasi qe kontratat dhe nenshkrimet e tyre publikohen dhe ne faqet e autoriteteve kontraktuese andaj ky fakt na ben te dyshojm edhe me shume se OE i rekomanduar per kontrat eshte i pa pergjegjshem dhe se nuk i ka ofruar deshmit ne lidhje me kerkesat e lartecekura pra OE i rekomanduar per kontrate nuk e ka ofruar listen e kontratave dhe tri kontratat bashk me referenca.

Gjithashtu ne dyshojm se OE i rekomanduar per kontrate eshte i papergjegjshem edhe per faktin se nuk ka permbushur kerkesen 3 ku eshte kerkuar autorizim nga prodhuesi per shitjet dhe servisim ashtu siq e cekem me larte pasi qe ky dokument si dokumentet e tjera eshte deklaruar sekret afarist. Pra ne dyshojm se OE i rekomanduar per kontrate nuk ka prezantuar ne oferte fare autorizimin andaj eshte i papergjegjshem.

Po ashtu ne dyshojm se OE i rekomanduar per kontrate eshte i papergjegjshem edhe per faktin nuk e permbush kerkesen 4 dhe 5 ne lidhje me ISO Certifikaten 9001 per operatorin ekonomik dhe ISO Certifikaten 13485 dhe CE certifikaten per prodhuesin. Ne dyshojm se OE i rekomanduar per kontrate nuk i ka prezantuar fare certifikatat e larteckura ose ka prezantuar certifikata tjera te cilat nuk jane konform kerkesave te FDT dhe te njoftimit per kontraten.Dyshimet tona po shtohen edhe njokohesisht po vertetohen edhe me shume pasi qe ne lidhje me ISO Certifikatat 13485 dhe CE certifikaten e prodhuesit kemi kontrolluar dhe gjate kontrolles ne Kine ne kemi vertetuar direkt nga prodhuesi se OE i rekomanduar per kontrate nuk posedon keto certifikata specifikisht per stelizatorin plasam. Andaj sa i perket vertetimit nga prodhuesi fakti se OE i rekomanduar per kontraten eshte i papergjegjshem po vertetohet edhe me shume dhe dyshimet jane edhe me te medha ne momentin qe OE i ka deklaruar sekret afarist edhe certifikatat e lartecekura.

OE i rekomanduar per kontrate dyshojm se eshte i pa pergjegjshem edhe per faktin se ky OE nuk i ka plotesuar edhe kerkesat me nr.6 Lista e pjeseve rezerv dhe 7.Licenca e AKPPM pasi qe nese do ti plotesonte keto kerkesa nuk do ti deklaronte si sekrete afariste. Gjithashtu ne dyshojm se OE i rekomanduar per kontrat nuk e ploteson edhe kerkesen nr.8 ku eshte kerkuar Katalogu i nenvizuar pasi qe edhe katalogu u prezantua sekret afarist ose nuk ka ofruar fare.

Po ashtu dyshojm se OE i rekomanduar per kontrate nuk i ploteson edhe specfikimet teknike te FDT andaj kerkojm nga ju qe te detyroni AK te vertetoj edhe njeher se ai permbush apo jo te gjitha kerkesat e FDT dhe njoftimit per kontraten OE i rekomanduar.

Gjithashtu edhe OE **Arben S.Ismajli B.I** i renditur si i dyti me çmim ne kete aktivitet te prokurimit dyshojm se eshte i papergjegjshem per faktin se nuk na eshte lejuar qasja ne dokumentacionin e tij.

Ne dyshojm se OE i lartecekur eshte i papergjegjshem sepse nuk i ka plotesuar te gjitha kerkesat e FDT dhe te njoftimit perkontrate perkateshisht tek neni 8.1&8.2 tek kapaciteti ekonomik dhe financiar ku kerkesa ka qen ..Vertetim bankar se ka qarkullim bankar se paku 12.000.00 euro per tri vitet e fundit., ndersa si deshmi dokumentare eshte kerkuar ..OE duhet te deshmon me vertetim nga banka komerciale qe ka qarkullim 120.000.00 euro per tri vitet e fundit Pra ne dyshojm se OE i ekomanduar per kontraten nuk e ploteson kere kerkes te larte cekur dhe eshte i pa pegjegjeshem.

Gjithashtu ne dyshojm se OE i ekomanduar per kontratë është i pa pergjegjshem edhe për faktin se nuk i ka plotesuar te gjitha kerkesat e FDT dhe njoftimit per kontrate perkateshisht kerkesat tek kapaciteti teknik dhe profesional neni 91.&9.2 ku kerkesae ka qen *1.Listen e kontratave te realizuara per tri vitet e fundit 2.Se paku tri kontrata dhe tri rreferenca per lami te ngjajshem 3.Autorizim nga prodhuesi per shitje dhe servisim 4.çertifikata ISO 13485 per prodhuesin dhe CE Certifikata per prodhuesin 6.Lista e pjeseve rezerv 7.Licenca nga AKPPM 8.Katalogu i nenvizuar ndersa si deshmi dokumentare eshte kerkuar 1.OE duhet te deshmoj me lsitën e kontratave te realizuara per tri vitet e fundit 2.OE duhet te deshmoj tri kontrata dhe tri referenca ne lami te ngjajshme 3.OE duhet te deshmon me autorizim nga prodhuesi per dhitje dhe servisim 4. OE duhet te*

deshmoj me certifikata iso 9001 per operatorin ekonomik dhe te kete validitet 5.OE duhet te deshmoj me certifikata iso 13485 per prodhuesin dhe CE certifikatat per prodhuesin 6.OE duhet te deshmoj me lista e pjeseve rezerv 7.OE duhet te deshmoj me licence nga AKPPM me validitet 8.OE duhet te deshmoj me katalogun e nenvizuar.

Pra duke u bazuar ne faktin se nuk eshte lejuar qasja ne dokumentet pasi qe ne dyshojm se OE i lartecekur nuk e ploteson kerkesen 1 dhe 2 te lartepermendur ne lidhje me kontratat pasi qe kontratat e realizuara eshte absurde te deklarohen si sekret afarist pasi qe kontratat dhe nenshkrimi i tyre punlikohet edhe ne faqet e autoriteteve kontraktuese andaj ky fakt na bene te dyshojm edhe me shume se OE Arben S.Ismajli B.I eshte i papergjegjshemdhe se nuk i ka ofruar deshmit ne lidhje me kerkesat e lartecekura pra OE i rekomanduar per kontrat nuk e ka ofruar listen e kontratave dhe tri kontratat te prezantuara bashk me referenca.

Gjithashtu ne dyshojm se OE i rekomanduar per kontrate eshte i papergjegjshem edhe per faktin se nuk ka permbushur kerkesen 3 ku eshte kerkuar autorizim nga prodhuesi per shitjet dhe servisim ashtu siq e cekem me larte pasi qe ky dokument si dokumentet e tjera eshte deklaruar sekret afarist. Pra ne dyshojm se OE i rekomanduar per kontrate nuk ka prezantuar ne oferte fare autorizimin andaj eshte i papergjegjshem.

Po ashtu ne dyshojm se OE i rekomanduar per kontrate eshte i papergjegjshem edhe per faktin nuk e permbush kerkesen 4 dhe 5 ne lidhje me ISO Certifikaten 9001 per operatorin ekonomik dhe ISO Certifikaten 13485 dhe CE certifikaten per prodhuesin.Ne dyshojm se OE i lartpemendur nuk i ka perezantuar fare certifikatat e lartecekura.

OE i Arben S.Ismajli B.I dyshojm se eshte i pa pergjegjshem edhe per faktin se ky OE nuk i ka plotesuar edhe kerkesat me nr.6 Lista e pjeseve rezerv dhe 7.Licenca e AKPPM pasi qe nese do ti plotesonte keto kerkesa nuk do ti deklaronte si sekrete afariste. Gjithashtu ne dyshojm se OE i rekomanduar per kontrat nuk e ploteson edhe kerkesen nr.8 ku eshte kerkuar Katalogu i nenvizuar pasi qe edhe katalogu u prezantua sekret afarist ose nuk ka ofruar fare.

Po ashtu dyshojm se OE Arben S.Ismajli B.I nuk i ploteson edhe specfikimet teknike te FDT andaj kerkojm nga ju qe te detyroni AK te vertetoj edhe njeher se ai permbush apo jo te gjitha kerkesat e FDT dhe njoftimit per kontraten ky OE.

Andaj duke u bazuar ne faktet e larte cekura pasi qe nuk eshte lejuar qasja ne dokumentet e OE Arben S.Ismajli B.I me kete rast nuk eshte respektuar nenin 10.3 i LPP dhe ne nuk kemi mundur te analizojm dokumentacionin e OE ne fjale ne dyshojm se ky OE eshte i papergjegjeshme ne lidhje me te gjitha kerkesat e lartecekura dhe duhet te shapllet i papergjegjshem.

Ne me dt.28.10.2020 kemi pranuar nje e-mail nga autoriteti kontraktues ne te cilin AK e ka cekur se na eshte lejuar qasja ne disa prej dokumenteve ku e ka cekur se zyrtari jone ka ber disa foto dhe disa dokumente i ka marr ne kopje fizike dhe gjithashtu e ka cekur se ne asnje menyr nuk ka thene se gjithe oferta e OE eshte sekret afarist mirepo ky arsyetim i AK nuk qendron per faktin se AK po ve veten e saj ne lajthitje sepse ne emailin e dt.23.10.2020 e ka cekur shume qart se *„Duke u bazuar ne nenin11 informatat sekrete afariste ku te gjitha dokuemntet e tenderit te cilat janë dorëzuar nga OE konform nenit 68,69 dhe 70 trajtohen si sekrete afariste. Dokumenti i tenderit i derguar nga OE e papergjegjeshem dhe munt te ndikon ne demtim te biznesit dhe demit material.,* pra nga emaili i permendur me larte OE i rekomanduar per kontrate e ka deklaruar te gjith dokumentacionin e tij sekret afarist dhe arsyetimi i AK se nuk qendron ky pretendim eshte shume kunderthenes dhe njekohesisht edhe i pa bazuar.

Ndersa ne lidhje me arsyetimin e AK ku e ka cekur se OE i rekomanduar per kontraten i ka plotesuar te gjitha kerkesat e FDT dhe te njoftimit per kontrate ky arsyetim i AK nuk qendron.per faktin se nese ky OE do te kishte plotesuar kerkesat e FDT dhe njoftimit per kontrate ateher AK me faktet dhe deshmi do te na vertetonte se pretendimet tona nuk qendrojn mirepo qe nuk ka ofruar asnje fakt apo deshmi se OE i rekomanduar per kontrate eshte i pa pergjegjeshem.

Ne emailin te cilin e kemi pranar me dt.28.10.2020 nga ana e AK eshte cekur qarte nga se njftojm me kohe per vendimin e AK lidhur me kerkesen tone per rishqyrtim. AK eshte munduar vetem te na e humb afatin ohor per parashtrim te Ankeses ne OSHP pasi qe nuk ka derguar asnje vendim per refuzim apo aprovim te kerkeses ton per rishqyrtim.

Perkundrazi sot me dt.30.10.2020 AK ka publikuar njofimin per dhenie te kontrates edhe pse nuk kemi marr ndonje vendim per refuzimin e kerkeses tone per rishqyrtim. AK me kete veprim nuk i ka respektuar dispozitat ligjore te nenit 108/A te LPP ku eshte cekur shume qarte se:

..Autoriteti kontraktues mundet me ane te nje vendimi:
1.1.te refuzoj kerkesen e propozuar pershqyrtim si te pabazuar.
1.2.te miratoj nje kerkes per rishikim si te bazuar dhe anuloj pjeserisht ose teresisht vendimin e miratuar pra perderisa AK nuk na ka derguar vendim per refuzim aapo aprovim te kerkeses per rishqyrtim shihet qart se nuk eshte respektuar dispozita e lartecekur e LPP.

Gjithashtu AK me publikimin e njoftimit per dhenie te kontrates nuk ka respektuar afatet ligjore per pranueshmerin e ankeses ne OSHP perkatesisht nuk i ka respektuar dispozitat ligjore te LPP Nenit 109 ku eshte cekur shume qarte se: *Ankesa ne OSHP duhet te dorezohet brenda dhjete (1) diteve pas marrjes se vendimit te lehsuar nga autoriteti kontraktues ne proceduren paraprake te zjedhjes se mosmarreshjes ne perputhje me nenin 108/A te keti ligji*"pra duke u bazuar ne dispozitat e lartecekura shihet se ju keni publikuar njoftimin per dhenie te kontrates pa kaluar afati ligjor per parashtirmin e ankeses ne OSHP prej 10 ditesh dhe gjithashtu pa publikuar nje vendim per refuzim apo aprovim te kerkeses tone per rishqyrtim edhe perkunder faktit se ju ne emailin e lartecekur e keni thekesuar s do te ju informojm ne lidhje me kerkesen tuaj per rishqyrtim.Ky veprim i juaji verteton edhe me shum faktin se OE i rekomanduar per kontrate eshte i pa pergjegjeshem pasi qe jeni munduar qe sa me shpejt te beni publikimin e vendimit per dhenje te kontrates vetem e vetem qe ne mos te bejm ankes ne OSHP.

Duke u bazuar ne te gjitha deshmit dhe faktet qe u ceken me larte konstatojm se ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i tendereve nuk eshte bere ne harmoni me nenin 59 te LPP sepse eshte ekomanduar per kontrate OE i cili nuk ka plotesuar te gjitha kerkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftomit per kontrate.

Gjithashtu nuk eshte respektuar edhe kriteri kryesor per dhenie te kontrates e qe ka qene tenderi i pergjegjeshem me qmimin me te ulet siq parashihet edhe ne nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP sepse ekeni rekomanduar per kontrat operatorin ekonomik te papergjegjeshem.

Gjithashtu AK nuk ka respektuar edhe nenin 7 te LPP duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotesuar te gjitha kerkesat e FDT dhe njoftimit per kontrat nuk jemi shpallur fitues te keti tenderi por shihet se qellimi i AK eshte qe ne mos te shpallemi fitues te keti tenderi.Pragrafi 1 i nenit 7 te LPP e parasheh qarte se qe .. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatoret ekonomik ne menyr te barabart dhe jo-disktiminuese dhe do te veproj ne menyr transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 te LPP parasheh qe gjate udhehqejes se aktiviteteve te prokurimit te gjitha autoritetet kontraktuese do te sigurojn qe (vi) tenderi i

zgjedhur te perputhet me te gjitha aspektet permbajtesore te kushteve kritereve dhe specifikimeve perkatese mirepo AK nuk i eshte permbajtur as kesaj dispozite ligjore.

Autoriteti kontraktues eshte dashur te kete ne konsiderat edhe nenin 1 te LPP pasi qe dihet se qellimi i ketij ligji eshte te siguroj menyren me efikase me transparente dhe me te drejt te shfrytezimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve te tjera te autoriteteve kontraktuse ne Kosove.

Duke u bazuar ne te gjitha faktet dhe deshmit qe u ceken me larte kerkojm nga OSHP qe te merr:

VENDIM

APROVOHET si e bazuar ankesa e OE **''SOLUTION D '' SHPK**
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK per dhenie te kontrates dhe lenda kthehet ne **RIVLERESIM**
DETYROHET autoriteti kontraktues qe gjate rivleresimit, ekzaminimit, vleresimit dhe krahasimit te ofertave te behen ne harmoni me kerkesat e dosjes se tenderit njoftimi per kontrate dhe konform dispozitave te LPP

Nese nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojm proceduren ligjore ne institucionet tjera kompetente.

Dispozitat e shkelura nga ana e AK sipas OE ankues janë:

- Neni 1 i LPP;
- Neni 7 i LPP;
- Neni 10 i LPP;
- Neni 59 i LPP;
- Neni 60 i LPP;
- Neni 64 i LPP;
- Neni 67 i LPP;
- Neni 69 i LPP;

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Fakti 1 – Kërkesa për qasje ne dokumentet tenderuese.

"Solution D" Sh.p.k
Rr. Ekrem Rexha nr. 28
Prishtinë - Kosovë
NUI: 810490798
Nr. Fiskal: 608372651

T: +383 38 24 32 33
F: +383 38 60 35 26
M: +383 45 55 50 64
E: sales@solutiond.net
Nr. Tvsh: 300837730

MEMO

Per: SPITALI I PERGJITHSHEM GJILAN

Zyrja e Prokurimit

Tenderi me titull: "Furnizim me Sterilizator Plazma me Material percjelles hargjues" me numër te prokurimit 220-70001-0731-20-5789-1-2-1

KERKESA PER QASJE NE DOKUMENTACION TENDERIK

Te nderuar,

Po ju drejtohemi me këtë shkresë me qëllim te qasjes ne dokumentet tenderike dhe raportin e vleresimit te tenderit me titull: "Furnizim me Sterilizator Plazma me Material percjelles hargjues" me numer te prokurimit 220-70001-0731-20-5789-1-2-1.

Kerkesa jone për qasje publike është e bazuar ne Nenin 10 te Ligjit mbi Prokurimin Publik. Shpresojme qe ne afatin sa me te shkurter te treguni konen per qasje ne dokumentet e lartecekura.

Ju falenderojme ne mirekuptim.

Mersad Berisha
23.10.2020

tion

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga **OE "SOLUTION D SH.P.K"**, lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Furnizim me Sterilizator Plazma me Material percjelles hargjues**" me nr. të prokurimit **220-70001-0731-20-5789-1-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK), **Spitali i Përgjithshëm ne Gjilan.**

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

Ne si komison i vleresimit mbeshtesim rekomandimin tone per dhenie te kontrates per operatorin ekonomik **Made-Kos** i cili i ka plotesuar te gjitha kriteret.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Pas shqyrtimit ne detaje te procedurës se tenderit si dhe shqyrtimit te pretendimeve ankimore te OE dhe dokumentacioni ne dispozicin te kësaj procedure te prokurimit eksperti shqyrtues jep këtë mendim:

AK ne proceduren e tenderimit ka pasur gjithshejt tri (3) oferta nga ana e operatoreve ekonomik, që të tre (3) operatoret ekonomik janë te shpallur te përgjegjshëm nga ana e komisonit vlerësues. Ne bazë te ***Nenit 59 te LPP*** *është përgjegjësi e Komisonit dhe Autoriteti kontraktues qe te bej vleresimi, krahasimin dhe ekzaminimin e ofertave tenderuese te operatoreve ekonomik.*

Pretendimi ankimor i OE **„SOLUTION D " SHPK** është se Autoriteti kontraktues nuk ka lejuar qasjen ne dokumentet tenderuese me arsyetimin se janë te klasifikuara si sekrete afariste ne bazë te **Nenit 11 te LPP.**

Operatori ekonomik ankues **„SOLUTION D " SHPK** me datën 23.10.2020 ka paraqitur kërkesën për qasje ne dokumentet tenderuese te operatoreve ekonomik ofertues.

Në bazë te **Nenit 114 te LPP paragrafit 1 pikës (ii)** kam kontaktuar autoritetin kontraktues me datën 03.11.2020 lidhur me kerkesen per qasje ne dokumentet tenderuese te paraqitur nga ana e OE ankues ku kam kërkuar nga AK si ne vijim: .. *Po ju shkruaj ne cilësin e ekspertit shqyrtues lidhur me procedurën e prokurimit "Furnizim me Sterilizator Plazma me Material percjelles hargjues" me nr. të prokurimit 220-70001-0731-20-5789-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK), Spitali i Përgjithshëm ne Gjilan.Ne kete procedur siq jeni te njoftuar keni ankes te dorzuar ne OSHP nga ana e OE sipas ankesës nr.871/20 te dt.30.10.2020.Pretendim ankimor është mos lejimi ne qasjen e dokumenteve te operatorit ekonomik ne baze te LPP, ju lutemi na dergoni vendimin e AK mbi pranimin e sekretit afarist te paraqitur nga ana e OE si dhe procesverbalin e qasjes.Mundesisht brenda dites te pergjegjeni ne kerkesen tone".*

Me datën 04.11.2020 kam pranaur kete përgjegjie nga ana e AK si ne vijim: .. *I nderuar z. Bajrami ne attachment gjeni te bashkangjitur deklaraten afariste. Ndersa lidhur me kerkesen tuaj per proceverbalin e qasjes nuk kemi bere e kemi njoftuar edhe ne email, edhe pse operatori ekonomik ka qene zyrtarisht ne zyret tona i ka shikuar te githa dokumentat dhe ka thene qe te githa i paska . por e kam njoftuar se nuk kam te drejti ti jap sepse eshte nenshkruar ANEKS 3 . Sa i perkete te gjtha dokumentat tjera jane ne Sistem E Prokurim.*

Autoriteti kontraktues me rastin e paraqitjes se sekretit afarist nga ana e operatorit ekonomik është dashur qe te veproj konform Nenit 11 paragrafit 5 te LPP-së dhe te trajtoj ne mënyr te duhur sekretin afarist te paraqitur nga ana e OE, dhe AK nuk ka respektuar kët dispozit duke mos treguar, njoftuar se cilat dokumente pranohen si sekret afarist por qe ka pranuar të githa si te tilla. Andaj ne këtë rast AK është dashur që ne bazë te Nenit 11 paragrafit 3 te shqyrtoj se kerkesat per sekret afarist e ter dokumentacionit ai përmbushin pikat 3.1, 3.2 dhe 3.3 te paragrafit 3 te Nenit 11 te LPP, andaj pretendimi ankimor i operatorit ekonomik **<u>është i bazuar</u>** dhe udhezohet AK qe te veproj konform **Nenit 7, 10 dhe 11** sa i përket qasjes se dokumentet tenderuese.

<u>Pretendimi ankimor</u> se OE i rekomanduar **"SOLUTION D SH.P.K"**, nuk ka ***„Vertetim nga banka se ka qarkullim bankar se paku tri vitet e fundit ndersa si deshmi eshte kerkuar OE duhet te deshmoj me vertetim nga banka komerciale qe ka qarkullim 120,000.00 euro per tri vitet e fundit.*** Nuk qëndron dhe është i pa bazuar pasi që OE ka prezantuar dokumentin, vëretimin bankar nga banka PCB me qarkullim konform kerkeses se Dosjes se tenderit, andaj ky pretendim është i **<u>pa bazuar.</u>**

<u>Pretendimi ankimore</u> se operatori ekonomik i rekomanduar **"SOLUTION D SH.P.K"**, nuk ka dokumentet sipas dosjes se tenderis te kërkuara tek kapaciteti teknik dhe profesional neni 91.&9.2 i dosjes se tenderit, është pa bazuar pasi që Operatori ekonomik i rekomanduar ka dorzuar:

1.)Listen e kontratave te realizuara per tri vitet e fundit **(operatori ekonomik ka prezntatur listën e kontratave dhe referencat)**

2.)Autorizim nga prodhuesi per shitje dhe servisim ***(BIOBASE BIODUSTRY (SHANDONG) CO.LTD te datës 13.10.2020***

3.)Certifikata ISO 13485 per prodhuesin dhe CE Certifikata per prodhuesin ***(Certifikata ISO 13485:2016 ME NR.45014; CE Certifikatën nga prodhuesi me nr.BKSD-20101302; CE 1282 ECM PED – D1 2018-DD33)***

4).Lista e pjeseve rezerv ***(nga prodhuesi me gjithsejt 12 artikuj e cila përmban edhe vulën e prodhuesit).***

5).Katalogu i nenvizuar ***(operatori ekonomik ka katalogun e nënvizuar nga prodhuesi BIOBASE).***

6).Licenca nga AKPPM ***(operatori ekonomik ka prezantur Licencen).***

Kurse **Certifikata ISO 9001** me anë te sqarimeve te publikuara ne e-prokurim nga ana e AK me datën 09.10.2020 është larguar si kërkesë andaj edhe ky pretendim ankimor është **<u>pa bazuar</u>**.

<u>Pretendimi ankimor</u>, se AK nuk është përgjegjur ndaj kërkesës për rishqyrtim te parashtruar nga ana e operatorit ekonomik **„SOLUTION D SH.P.K"** nuk qëndron pasi që OE me datën 27.10.2020 ka paraqitur kërkesën për rishyqrtin pran AK kurse AK me datë 29.10.2020 ka kthyer përgjegjien ndaj kërkesës për rishqyrtim e cila është brenda afateve te përcaktuara me LPP, Nenin 108/A pragrafin 6 andaj pretendimi ankimor është i **<u>pa bazuar.</u>**

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke pasur parasysh sqarimet e lartëcekura dhe bazuar ne zhvillimin e procedurës se prokurimit dhe dokumentacionit te ofertave dhe vleresimit, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohët **pjesësisht si e bazuar**, të anulohet njoftimi për dhanie te kontratës dhe procedura te kthehët ne **rivlersim**, rekomandohet AK që te respektohet Neni 59 i LPP si dhe Nenet 7, 10, 11 gjatë procedures se rivlersimit dhe pas sajë.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Spitalit te përgjithshën Gjilan.
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues - "SOLUTION D SH.P.K"